



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1275/2 prot.,

Datë 23.05.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Sark” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedura e Hapur”, me REF-02161-04-22-2024 me objekt “Blerje cakulli”, me fond limit 13,299,360 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Sark” SHPK me NIPT K52531415H, me adresa: Rruga “Skëndërbeu:, Lagjia 8 Shkurti”, Fier.
- Subjekti Interesuar:** Operatori ekonomik “Senka” SHPK me NIPT J94808405Q, me adresa: Xhevdet Nepravishta, Fier, Lushnje.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Kavajë.
Adresa: Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë.

Në datë 22.05.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër 1275 Prot., e operatorit ekonomik “Sark” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedura e Hapur”, me REF-94403-02-02-2024 me objekt “Procedura e Hapur”, me REF-02161-04-22-2024 me objekt “Blerje cakulli”, me fond limit 13,299,360 (trembëdhjetë milion e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 09.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sark” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose

enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi kundërshtimin e arsyeve të skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

SARK shpk Oferta juaj eshte refuzuar per arsyet e meposhtme:

1. Nga verifikimi i kryer ne dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE, operatori ekonomik Tabi Construction nuk ka paraqitur origjinale ose kopje te noterizuar Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar per bilancin e vitit 2023 te ngarkuar ne SPE. Dokumenti i paraqitur nuk eshte origjinal ose kopje e noterizuar, sic kerkohet ne DST.

2. Nga verifikimi i kryer per dokumentat e tenderit te paraqitura ne SPE OE nuk permbush piken 2.3.3 te DST nuk eshte i pajisur me certificate ISO 9001, ISO 14001, ISO 45001 per mallrat objekt prokurimi. Ne fushat e aktivitetit per te cilat eshte certifikuar nuk perfshihen produktin objekt prokurim.

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 23.05.2024

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro